



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.7/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e ankuesit F.J., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati N.E., nga Prizreni ndaj gjyqtarës E.S., Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit të lartcekur sipas lëndës C.nr.664/17, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me cit. 18.04.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit (të paditurit) F.J., nga Prizreni, ndaj gjyqtarës E.S., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm- Divizioni Civil.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës F.J., nga Prizreni, në ankesën e tij ka cekur se ka vërejtje ndaj gjyqtarës E.S., për shkak të zvarritjes së lëndës C.nr.644/17 ku i njëjti është palë e paditur dhe paditëse është F.J., ish bashkëshortja e tij , në çështjen civile ku objekt kontesti është pronësia e përbashkët. Sipas ankuesit gjyqtarja ka mbajtur disa seanca, por ende nuk ka epilog të këtij kontesti dhe konsideron se e njëjta është duke e zvarritur dhe ende nuk ka marr ndonjë vendim përfundimtar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes E.S., ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës dhe me cit. 14.04.2023 ankuesi F.J., nëpërmjet avokatit të tij ka dorëzuar një deklaratë në të cilën ka cekur se e tërheqë ankesën e tij pasi që nuk ka pasur njohuri për zhvillimin e çështjes dhe njëherit ka kërkuar falje nga gjyqtarja e rastit .

Bazuar në të lartcekurat Autoriteti Kompetent konsideron se: **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka pasur bazë për shkelje disiplinore pasi që pretendimet e ankuesit (të paditurit) F.J., nuk qëndrojnë. Me verifikim të shkresave të lëndës dhe sipas deklaramit të gjyqtarës në këtë çështje janë caktuar shumë shqyrtime që nga viti 2017 dhe për shkak të kompleksitetit të lëndës e njëjta është ende duke u

gjykuar dhe është në përfundim e sipër. Gjithsesi edhe vet ankuesi ka tërheqë ankesën e tij që tregon se ankesa e tij është joserioze dhe e pabazuar.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.7/2023, me dt. 18.04.2023

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



Shpresa Emra

atë e drejta e ankesës.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.